REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. prot. Tiranë, më 07.07.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

ZNJ. E N
INSTITUTI SHQIPTAR PËR STUDIME LIGJORE DHE TERRITORIALE
(Qendra A.L.T.R.I)
Të dhënat e kontaktit: Rr. ". ' Nr.
E-mail:
Tel:

E nderuar znj. N

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ardhur përmes postës elektronike të koordinatorit për median dhe të drejtën e informimit në datën 28.6.2022, regjistruar me tonën me nr. prot., datë 28.6.2022, dëshirojmë t'ju sqarojmë se:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në zbatim të detyrimeve ligjore, ka referuar deri tani në total pranë organeve kompetente subjekte rivlerësimi, prej të cilëve janë prokurorë dhe gjyqtarë.

Në lidhje me pyetjen e fundit, ju informojmë se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është organ i cili rivlerëson gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë dhe kryen për secilin prej tyre hetim të thelluar administrativ dhe jo penal. Si i tillë Komisioni nuk merr vendime të formës së prerë, pasi është shkalla e parë e rivlerësimit kalimtar për subjektet dhe, vendimet e tij mund të ankimohen nga subjektet ose Komisionerët Publik, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, si shkallë e dytë dhe përfundimtare e rivlerësimit kalimtar. Në bazë të nenit 179/b të Kushtetutes, Aneksit të saj dhe nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, vendimet e KPA-së janë vendime të formës së prerë *ex-legge*,

Nëse gjatë hetimit administrativ në dosjen e subjektiti të rivlerësimit kontatohen elementë të dyshimtë, ato referohen pranë organit të akuzës, i cili, më pas, përcakton nëse përbëjnë vepër penale ose jo.

Duke ju falënderuar, urojmë punë të mbarë!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Edmond Veçani